



A.nr. 633/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtare me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.633/2026 të datës 16.06.2026, të parashtruar nga ankuesi V.G, kundër organit të punësimit: Komuna e Kaçanikut, në çështjen juridik “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.633/2026, e datës 16.06.2026, e parashtruar nga ankuesi V.G.

A r s y e t i m

Ankuesi, V.G (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 16.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr. 633/2026, me pretendimet ankimore lidhur me konkursin RN0019654, të datës 23.04.2026, për pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë”, klasa e pozitës Drejtues i Ulët, të zhvilluar nga Komuna e Kaçanikut.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 19.06.2026 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Kaçanikut, ndërsa kjo e fundit, më datë 23.06.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr.633/2026 të datës 16.06.2026; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokoll 01. Nr. 104/02-1331/26, i datës 05.06.2026, i nxjerr nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kaçanikut; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin V.G; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.06.2026, dërguar nga R.K, për H.G; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll

633/2026, e datës 23.06.2026; Kërkesë për fillimin e procedurës së rekrutimit e datës 21.04.2026; Përshkimi i detyrave të punës për pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë”; Konkursi me numër reference RN00019624, i datës 23.04.2026; Lista e Aplikantëve; Njoftimi i datës 05.06.2026, i nxjerr nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kaçanikut; Aplikacioni i V.G, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 10802, e datës 13.01.2020, për V.G, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Kontrata e Punës e datës 30.11.2017; Letër rekomanduese e datës 06.06.2026; Vendimi me numër protokolli 01. Nr.104/02-13756, i datës 09.06.2026, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Kaçanikut; Akt Emërimi i datës 17.09.2025, për V.D; Akt Emërimi i datës 18.09.2025, për H.Z; Akt Emërimi i datës 17.09.2025, për V.D; Akt Emërimi i datës 17.09.2025, për M.B; Akt Emërimi i datës 14.05.2024, për Sh.C; Akt Emërimi i datës 17.05.2024, për R.S; Renditja përfundimtare e kandidateve e datë 01.06.2026; Njoftimi i datës 19.06.2026, i nxjerr nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kaçanikut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Kaçanikut, më datë 23.04.2026, ka shpallur konkursin me numër reference RN00019624 për pozita e punës “Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë”, klasa e pozitës Drejtues i Ulët, numri i kërkuar (1) pozitë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 24.04.2026 deri me 23.05.2026, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi.

Ankuesi me datë 16.06.2026, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se me vendimin me numër protokolli 104/02-13371/26, të datës 05.06.2026, me është refuzuar aplikacioni me arsyetimin së dëshmia e përvojës së punës e ngarkuar në sistem nuk është e vulosur dhe e nënshkruar nga punëdhënësi dhe si e tillë konsiderohet jo valide me tej ankuesi pretendon rishqyrtimin e vendimit për refuzimin e aplikacionit të tij, si dhe pranimin e dokumentacionit, të plotësuar si dëshmi valide, si dhe vazhdimin e kandidaturës së tije në faza e mëtejme të konkursit.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se:...12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative..* si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil., me të cilin shprehimisht parashihet se: *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve, në rast të pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtruar me datë 16.06.2026, sepse si pas përgjigjes në ankesë të datës 23.06.2026 lidhur me konkursin RN0001964 të dërguar nga Menaxherja e Personelit e Komunës së Kaçanikut, ku përmes përgjigjes thuhet se; testimi me shkrim për pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë”, është mbajtur me datën 17.06.2026, prandaj bazuar në këtë Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar me datën 16.06.2026, andaj mbi bazën e kësaj rezulton së ankesa e ankuesit është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendoi si në dispozitivin e këtij.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA: A.nr. 633/2026

Rushit Kajtazi

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, V.G;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kaçanikut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së